

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME VENDIN PRITËS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor. Marrëveshja ka si qëllim kryesor përcaktimin e rregullave të funksionimit të Fondit, statusin ligjor dhe privilegjet e imunitetet e stafit që do të ushtrojë aktivitetin në këtë strukturë.

Me krijimin e një fondi të përbashkët, arritur me marrëveshjen “Për themelimin e FBP” në Pragë, më 13.11.2015, si dhe me formalizimin e tij, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje synohet jo vetëm realizimi i financimit të projekteve të vogla e të mesme në fusha si arsimi, kultura, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, mjedisi, bashkëpunimi ndërkufitar, por edhe afrimi ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe forcimi i bashkëpunimit rajonal, duke stabilizuar më tej hapësirën e Evropës Juglindore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, me qëllim realizimin e objektivave të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, të parashikuara në programin e Këshillit të Ministrave për politikën e jashtme dhe, veçanërisht, objektivit për thellimin e bashkëpunimit rajonal, i cili është një ndër parimet bazë që udhëheqin politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Themelimi i Fondit të Ballkanit Perëndimor është bërë në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, nenet 13 e 14, dhe ratifikimi i marrëveshjes me vendin pritës do të formalizojë aktivitetin e Fondit. Kjo iniciativë përbën një hap më tej në vizionin e Shqipërisë evropiane si model frymëzimi në rajon. Qëllimi i Fondit është përmirësimi i marrëdhënieve dhe thellimi i bashkëpunimit me vendet fqinje në fusha të ndryshme, duke ndihmuar në ruajtjen dhe konsolidimin e paqes dhe stabilitetit demokratik, me pikësynimin final ankorimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në NATO dhe BE.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Republika e Shqipërisë, ndër të tjera, merr përsipër të angazhohet në zhvillimin e bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar si dhe në zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, prej nga i lind edhe detyrimi për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe për bashkëpunimin rajonal, synimi i të cilave është rritja e fushave të bashkëpunimit dhe përforcimi i këtij bashkëpunimi ndërmjet vendeve në fjalë, siç është edhe marrëveshja për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Marrëveshja me vendin pritës ndihmon në zbatimin e marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, e cila përbën një objektiv strategjik për anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet evidentimit të rolit të saj konstruktiv në rajon.

Pranimi nga vendet anëtare të FBP-së për vendosjen e selisë së Fondit në Tiranë dhe zgjedhjen e drejtorit të parë ekzekutiv nga Shqipëria tregon për kontributin dhe rolin që ka luajtur dhe luan Shqipëria në Rajon.

Hapja e zyrës së Fondit të Ballkanit Perëndimor me seli në Tiranë tregon qartazi vullnetin politik dhe vizionin e ri që Shqipëria ka për rajonin. Kjo është një iniciativë që do të shërbejë si instrument për përsheptimin e bashkëpunimit rajonal.

Pavarësisht nga kontributet dhe roli aktiv që ka luajtur Shqipëria në rajon, deri më sot asnjë nismë rajonale nuk ka pasur selinë e saj në Shqipëri. Formalizimi i këtij procesi nëpërmjet ratifikimit të marrëveshjes me vendin pritës, përveç rëndësisë në kuadër të bashkëpunimit rajonal, është përfundim i natyrshëm i përpjekjeve të mëdha diplomatike për të sjellë në vend për herë të parë selinë e një nisme rajonale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me pikën 1, të nenit 121, pika 1të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, marrëveshjen për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, nënshkruar në Pragë, më 13.11.2015, hyrë në fuqi më 25.5.2017, dhe ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja është miratuar, në parim, me vendimin nr.156, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, dhe është nënshkruar në Tiranë, më 19.4.2018.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, më 13.11.2015, vendet palë, Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova dhe Serbia dakordësuan për vendosjen e selisë së Fondit në Tiranë. Marrëveshja me vendin pritës, e nënshkruar më 19.4.2018, është bazuar në statutin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, pjesë e marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Marrëveshja me vendin pritës është strukturuar me 2 pjesë; pjesën hyrëse “preambula” dhe 24 nene. Pas sqarimit, bërë në nenin 1, për termat që do të përdoren në marrëveshje, nga neni 2 dhe deri në nenin 10 sanksionohen privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për funksionimin e sekretariatit të Fondit.

Në nenin 2, “Selia” parashikohet ofrimi pa pagesë, për 5 (pesë) vitet e para, i godinës ku Fondi do të ushtrojë aktivitetin e tij.

Në nenin 3 parashikohet rregullimi i “Statusit ligjor” të Fondit, i cili, duke qenë se është themeluar si një organizatë ndërkombëtare, do të gëzojë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji shqiptar dhe do të ketë kapacitetin ligjor të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të tij.

Neni 4 parashikon të drejtën që sekretariati i Fondit të përdorë flamurin dhe simbolet e tij. Për përmbushjen e aktivitetit të Fondit, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje vendi pritës siguron paprekshmërinë e godinës, të dokumenteve, materialeve arkivore apo pajisjeve kompjuterike që i përkasin dhe janë në pronësi të Fondit, parashikim i nenit 5.

Në nenet 7 dhe 8 parashikohen përjashtime nga taksat për Sekretariatit e Fondit dhe përdorimin e fondit të tij, në të njëjtat kushte siç është parashikuar për misionet diplomatike, të akredituara në Shqipëri.

Duke u bazuar në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, të vitit 1961, si dhe në marrëveshjen për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor të vitit 2015, marrëveshja me vendin pritës ka parashikuar rregullimin e privilegjeve dhe të imuniteteve për stafin që do të ushtrojë aktivitetin te Fondi, rregullime këto të bëra nga neni 10 deri në nenin 17. Privilegjet e ofruara dhe imunitetet që do të gëzojë personeli ndërkombëtar do të jenë në përputhje me shkallën e tyre të përfaqësimit.

Në pjesën e fundit, neni 19, janë parashikuar rregullime lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilat do të realizohen me negociata ndërmjet palëve. Në

një nen më vete, neni 20, janë parashikuar dhe ndryshimet e mundshme të marrëveshjes si dhe forma e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve.

Vetë marrëveshja, në nenin 21, parashikon si kohë të hyrjes në fuqi ditën kur Republika e Shqipërisë njofton Sekretariatit e Fondit se ka përfunduar procedurat e brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

Pas nënshkrimit, marrëveshja në zbatim të neneve 121 dhe 155, të Kushtetutës, do t'u nënshtrohet procedurave të ratifikimit, pasi ka të bëjë me përjashtim/lehtësim nga taksat të një subjekti të caktuar dhe stafit të tij.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucioni që ngarkohet me zbatimin e kësaj marrëveshjeje është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i marrëveshjes nuk sjell efekte direkte nga pikëpamja buxhetore, pasi ambienti ku ka selinë Sekretariati i Fondit, i ofruar pa pagesë, për një periudhë 5- vjeçare, bërë në zbatim të marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, arritur në Pragë më 13 tetor 2015, është pronë e shtetit shqiptar, e cila administrohet nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik. Vlera e përafërt që do të përfitohej nga dhënia me qira e këtij ambienti, për 5 vjet, ku do të përfshiheshin pagesat për (qira, ujë, drita dhe kancelari) është rreth 72 000.00 euro.

Përveç shumës së sipërpërmendur, pala shqiptare nuk do të vjelë ato tatime dhe taksa për të cilat Fondi dhe stafi ndërkombëtar janë të përjashtuar si përfitues të privilegjeve të njohura edhe nga Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike.

KËSHILLI I MINISTRAVE